



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT DEPARTAMENTI I AUDITIMIT TË PERFORMANCËS

Adresa: Bulevardi "Dëshmorët e Kombit", nr. 3, Tiranë; Tel-Fax: 0693067738

E-mail: rmuca@klsb.org.al; Web-site: www.klsb.org.al

AUDITIM PERFORMANCE

“RESPEKTIMI I TË DREJTËS SË AUTORIT NË SHQIPËRI”

Përmbledhje Ekzekutive

Në zbatim të planit vjetor 2015, Kontrolli i Lartë i Shtetit, në kuadër të përmbushjes së funksionit të tij Kushtetues, zbatimit të Udhëzimeve dhe Standardeve Ndërkombëtare të Auditimit (INTOSAI, EUROSAI etj.), sipas shkresës nr. 196/1, datë 29.5.2015 “Program Auditimi”, ndërmoi auditimin me temë “*Respektimi i të Drejtës së Autorit në Shqipëri*”.

Ky auditimi u programua për t’u ushtruar në Zyrën Shqiptare për të Drejtën e Autorit (ZSHDA), Autoritetin e Mediave Audiovizive (AMA) dhe Ministrinë e Kulturës për periudhën e aktivitetit janar 2012- maj 2015.

Zyra Shqiptare për të Drejtën e Autorit është institucion qendror, me statusin e personit juridik publik, në varësi të Ministrisë së Kulturës. ZSHDA-ja e ushtron veprimtarinë në mbështetje dhe në zbatim të Kushtetutës, të Ligjit nr. 9380, dt. 28.04.2005 “Për të drejtën e autorit dhe të drejtat e tjera të lidhura me të”, të VKM nr. 232, dt. 19.04.2006 “Për krijimin dhe funksionimin e Zyrës Shqiptare për të Drejtat e Autorit”, si dhe të konventave e marrëveshjeve të tjera ndërkombëtare, ku Republika e Shqipërisë është palë. ZSHDA-ja ka si objekt të veprimtarisë mbikëqyrjen dhe monitorimin e respektimit të të drejtave të autorëve dhe të të drejtave të tjera të lidhura me të, nga subjektet, persona fizikë/juridikë, privatë ose publikë, përdorues të pronësisë letrare, artistike, shkencore.

Autoriteti i Mediave Audiovizive (AMA) është autoriteti rregullator në fushën e shërbimeve të transmetimeve audio, audiovizive dhe shërbimeve të tjera mbështetëse në territorin e Republikës së Shqipërisë. AMA është person juridik, i cili institucion e ushtron veprimtarinë e tij në mbështetje e në zbatim të Kushtetutës, të Ligjit nr. 97/2013 “Për Mediat Audiovizive në Republikën e Shqipërisë” dhe të legjislacionit në fuqi në Republikën e Shqipërisë.

Ministria e Kulturës ushtron funksione dhe ka në kompetencë hartimin dhe ndjekjen e politikave, përgatitjen e akteve ligjore dhe nënligjore, si dhe kryerjen e shërbimeve të nevojshme në fushën e kulturës e të trashëgimisë kulturore. Ministria e Kulturës është person juridik publik, me seli në Tiranë. Ky institucion e ushtron veprimtarinë e tij në mbështetje e në zbatim të Kushtetutës, të Ligjit nr. 90/2012 “Për organizimin dhe funksionimin e administratës shtetërore”, të VKM nr. 844, datë 27.9.2013 “Për përcaktimin e fushës së përgjegjësisë shtetërore të Ministrisë së Kulturës” dhe të legjislacionit në fuqi në Republikën e Shqipërisë.

Trashëgimia kulturore përbën identitetin e një kombi. Respektimi i së drejtës së krijuesve që e pasurojnë këtë trashëgimi i shërben mbrojtjes dhe rritjes cilësore të saj, edukimit kulturor të brezave dhe përparimit social- ekonomik të një vendi.

Respektimit të së drejtës së autorit i është dhënë një rëndësi e veçantë duke e përfshirë atë edhe në Deklaratën Universale për të Drejtat e Njeriut, të miratuar nga Asambleja e Kombeve të bashkuara më 10 Dhjetor 1948. Në nenin 27 të kësaj deklarate specifikohet se: *“Gjithkush ka të drejtë të mbrojë interesat morale dhe materiale, që rrjedhin nga çdo krijimtari shkencore, letrare dhe artistike, autor i të cilave është ai/ ajo vetë”*.

Duke qenë se e drejta e autorit trajtohet edhe në **nenin 58 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë**, në të cilën përcaktohet se:

1. *Liria e krijimit artistik dhe e kërkimit shkencor, vënia në përdorim si dhe përfitimi prej arritjeve të tyre janë të garantuara për të gjithë.*
2. *E drejta e autorit mbrohet me ligj.*

Nisur nga shqetësimi i vazhdueshëm i kompozitorëve, skenaristëve, autorëve të teksteve, interpretuesve, ekzekutuesve dhe producentëve për cenimin, përdorimin dhe shfrytëzimin e veprave pa miratimin e tyre, pa i shpërblyer ata dhe në kundërshtim me Ligjin, si dhe nga njohuritë e pakta që kanë përdoruesit e së drejtës së autorit, nga numri i madh i përdoruesve të saj në Shqipëri, nga të ardhurat e konsiderueshme që krijohen prej saj dhe nga industria e lidhur me të, me qëllim transparencën për publikun dhe Kuvendin e Shqipërisë, Kontrolli i Lartë i Shtetit planifikoi ushtrimin e auditimit të performancës për respektimin e të drejtës së autorit në fushën e muzikës dhe kinematografisë shqiptare.

Rëndësia e këtij auditimi performance ka të bëjë me vlerësimin e gjendjes faktike të respektimit të së drejtës së autorit dhe të drejtave të tjera të lidhura në **fushën e muzikës dhe të kinematografisë shqiptare** nga subjektet përdoruese audiovizive.

Në kuadër edhe të zbatimit të detyrimeve që lindin nga nënshkrimi i Marrëveshjes së Stabilizim Asocimit (neni 73), Qeveria Shqiptare ka miratuar Strategjinë Kombëtare për zbatimin e pronësisë intelektuale dhe industriale 2010-2015.

Objektivat kryesorë të kësaj strategjie janë:

1. Përfundimi i plotësimit të kuadrit rregullator dhe legjislativ.
2. Zhvillimi dhe forcimi i institucioneve, të përfshira në zbatimin e të drejtave të pronësisë intelektuale. Këtu do të përfshihen masa në fushën e teknologjisë së informacionit, trajnimeve profesionale. Kjo do të mbulojë gjithashtu zhvillimin e shërbimeve të tilla si: shërbimet e ndërgjegjësimit dhe arsimimit që duhet të ofrohen nga institucionet kryesore për partnerët vendas dhe grupet e interesit.
3. Forcimi i bashkëpunimit dhe koordinimit midis institucioneve, si në nivel kombëtar ashtu edhe në nivel rajonal apo me gjerë, në funksion të përmirësimit të punës në mbrojtje të të drejtave të pronësisë intelektuale.
4. Rritja e ndërgjegjësimit të publikut në Shqipëri lidhur me të drejtat e pronësisë intelektuale.

Strategjia për Pronësinë Intelektuale në Shqipëri ka për qëllim të identifikojë politikën e Qeverisë Shqiptare dhe strukturave që ajo administron për zbatimin të drejtave mbi këto pronësi, si dhe të stimulojë zhvillimin e një procesi gradual të forcimit të gjithë sistemit në funksion të zbatimit të kësaj përgjegjësie në të ardhmen.

Ndër institucionet, të cilat ngarkohen me zbatimin e kësaj strategjie janë: ZSHDA dhe Drejtoria e Përgjithshme e Patentave dhe Markave, të cilat në bashkëpunim me Drejtorinë e Përgjithshme

të Tatimeve, me Drejtorinë e Përgjithshme të Doganave, me Autoritetin e Mediave Audiovizive (ish-KKRT), me Drejtorinë e Përgjithshme të Policisë dhe institucione të tjera, duhet të synojnë përmbushjen e të gjithë objektivave të përcaktuara në këtë strategji.

Në objektivat themelore të vendosura nga kjo strategji mund të përmendim:

- Miratimin **brenda vitit 2011** të Ligjit të ri për të Drejtën e Autorit;
- Ngritjen e Inspektoratit të Tregut;
- Modernizimin dhe ngritjen e kapaciteteve institucionale të ZSHDA-së;
- Trajnimin e punonjësve, grupeve të interesit dhe punonjësve të institucioneve që kanë lidhje me monitorimin dhe zbatimin e së drejtës së autorit;
- Ndërmarrjen e fushatave ndërgjegjësuese.

Për periudhën 2012-2014, ZSHDA, në zbatim të Ligjit nr. 9380, dt. 28.04.2005 “Për të drejtën e autorit dhe të drejtat e tjera të lidhura me të” (LDA) dhe të VKM nr. 232, dt. 19.04.2006 “Për krijimin dhe funksionimin e Zyrës Shqiptare për të Drejtat e Autorit”, ka propozuar licencimin e **një** Agjencie të Administrimit Kolektiv dhe ka monitoruar aktivitetin e **katër** agjencive që operojnë në fushën e mbrojtjes së të drejtave të kompozitorëve, autorëve të teksteve, interpretuesve, ekzekutuesve, producentëve dhe autorëve që lidhen me produktin kinematografik shqiptar.

Bazuar në nenin 107 të LDA, Agjencitë e Administrimit kolektiv janë persona juridikë, që kanë si objekt të veprimtarisë së tyre mbledhjen e të ardhurave për përdorimin e veprave dhe shpërndarjen e tyre tek titullarët e të drejtës së autorit, të cilët ia kanë kaluar këto të drejta për administrim agjencisë së administrimit kolektiv.

Monitorimi i aktivitetit të këtyre agjencive ka konsistuar në kontrollin e aktivitetit financiar dhe përmbushjen e detyrimeve për shpërblimin e autorëve, detyrime këto të parashikuara nga nenet 114, 115 dhe 116 të LDA. ZSHDA ka konstatuar problematika në mirëfunksionimin e AAK dhe në dy raste i ka propozuar Ministrisë së Kulturës pezullimin e aktivitetit të tyre.

ZSHDA, në zbatim të dispozitave të LDA, ngarkohet gjithashtu me monitorimin e respektimit të së drejtës së autorit, identifikimin e rasteve kur kjo e drejtë çënohet nga subjektet përdoruese dhe vendosjen e masave administrative (gjoha). Për të përmbushur dhe objektivat e Strategjisë Kombëtare, ZSHDA ka kërkuar bashkëpunimin edhe me institucione të tjera siç janë Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve, Drejtoria e Përgjithshme e Doganave dhe Autoriteti i Mediave Audiovizive (ish-KKRT), me synimin e identifikimit të subjekteve cënuese dhe ndëshkimit të tyre.

Ndër politikat e tjera institucionale mund të përmendim organizimin e aktiviteteve trajnuese për punonjësit e saj dhe punonjësit e institucioneve që ligji i ngarkon me përgjegjësitë për mbrojtjen e të drejtës së autorit si dhe organizimin e disa fushatave sensibiluese për publikun e gjerë dhe subjektet përdoruese.

Bazuar në Ligjin nr. 97/2013 “Për Mediat Audiovizive në Republikën e Shqipërisë”, **Autoriteti i Mediave Audiovizive** duhet të garantojë respektimin e të drejtës së autorit dhe të drejtave të tjera të lidhura me të nga Ofruesit e Shërbimit Mediatik Audioviziv (OSHMA). AMA, si në fazën e licencimit, po ashtu edhe gjatë ushtrimit të kësaj licence nga OSHMA-të duhet të monitorojë dhe inspektojë veprimtarinë e këtyre subjekteve për respektimin e të drejtës së autorit, e cila është e lidhur ngushtë me të drejtën e transmetimit.

Në rastet kur AMA konstaton mosrespektimin e detyrimeve që rrjedhin nga neni 33 i Ligjit “Për mediat audiovizive në Republikën e Shqipërisë”, referuar dispozitave të nenit 133 të këtij ligji, vendos masa administrative (gjobë) për cënuesit e të drejtës së autorit.

Monitorimi i subjekteve kryhet nëpërmjet studios së monitorimit e cila mban njëkohësisht nën monitorim 15 subjekte transmetuese audiovizive, kryesisht në rrethet Tiranë dhe Durrës. Monitorimi i subjekteve të tjera kryhet sipas planeve të miratuara të inspektimit.

Ministria e Kulturës, nëpërmjet strukturave të varësisë realizon regjistrimin, mbikëqyrjen dhe monitorimin e respektimit të të drejtave të autorëve dhe të të drejtave të tjera të lidhura me të, nga subjektet, persona fizik/juridik, privat ose publik, përdorues të pronësisë letrare, artistike dhe shkencore.

Ajo gjithashtu harton dhe ndjek politikën për përgatitjen e akteve ligjore dhe nënligjore si dhe ushtrimin e shërbimeve të nevojshme lidhur me fushën e artit dhe kulturës.

Në këtë kontekst, Ministria e Kulturës në “Planin e Kulturës 2013-2017” ka përcaktuar që në kuadër të ligjit “Për të drejtat e autorit dhe të drejta të tjera të lidhura me të ” që pritet të miratohet, të rishikojë funksionimin e ZSHDA-së, si institucion varësie. Rishikimi i funksionit të kësaj zyre merr rëndësi të veçantë edhe për përmbushjen e detyrimeve të nenit 73 të MSA, i cili kërkon në mënyrë specifike përafrimin e legjislacionit shqiptar me *acquis communautaire*.

Në përfundim të punës audituese në terren, me shkresën nr. 196/3 datë 13.11.2015, iu dërgua projekt-raporti i auditimit subjektit të audituar. Raporti përfundimtar është hartuar në afatin ligjor të kthimit të Projekt-Raportit të auditimit.

Në përfundim, pasi Kryetari u njoh me Raportin Përfundimtar të Auditimit dhe projekt-vendimin e paraqitur nga grupi i auditimit të Departamentit të Auditimit të Performancës, shpjegimet e dhëna nga subjekti i audituar, mendimin për cilësinë e auditimit nga Drejtori i Drejtorisë Juridike dhe Zbatimit të Standardeve, vlerësimin mbi objektivitetin dhe cilësinë e auditimit nga Kryeaudituesi dhe Drejtori i Departamentit të Auditimit të mësipërm, në mbështetje të nenit 15, shkronja “c” të ligjit nr. 154/2014, datë 27.11.2014, “Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”:

KONKLUDO I:

Mosrespektimi i të drejtës së autorit është një problem që prek artistët që janë pjesë elitare e shoqërisë, duke ndikuar kështu në dekurajimin e tyre për të krijuar dhe pasuruar trashëgiminë e kombit.

Duke respektuar të drejtën e autorit, Shqipëria përmbush jo vetëm detyrimet që rrjedhin nga Marrëveshja e Asociimit Stabilizimit, por njëkohësisht vlerëson veprimtarinë krijuese të çdo autori, i cili kontribuon në njohjen dhe vlerësimin e kulturës shqiptare dhe jashtë kufijve.

Hartimi i politikave të suksesshme, të cilat synojnë monitorimin dhe inspektimin e veprimtarisë së subjekteve përdoruese të së drejtës së autorit, përdorimi sa më efektiv i burimeve njerëzore dhe logjistike, trajnimi i vazhdueshëm i punonjësve dhe bashkëpunimi midis ZSHDA-së dhe AMA-s, me synim evidentimin dhe ndëshkimin e cenuesve të së drejtës së autorit, duhet t'i shërbejë ndërgjegjësimit të subjekteve përdoruese transmetuese mediatike dhe publikut për respektimin e kësaj të drejte.

Respektimi i të drejtave të autorit nga të gjitha subjektet është i rëndësishëm jo vetëm për përfitimin e merituar pasuror dhe jo pasuror të vetë autorëve, por edhe për zhvillimin kulturor dhe ekonomik, pasi nga përdorimi i ligjshëm gjenerohen të ardhura, të cilat derdhen në buxhetin e shtetit.

Krahas objektivit të përgjithshëm të auditimit të performancës për të evidentuar dhe ndërgjegjësuar nëpërmjet rekomandimeve nëse po bëhen gjërat e duhura në mënyrën dhe kohën e duhur, objektivi specifik i auditimit të ushtruar në Zyrën Shqiptare për të drejtën e Autorit, Autoritetin e mediave Audiovizive dhe Ministrinë e Kulturës është auditimi i performancës së këtyre institucioneve me fokus optimizimin e raportit burime - rezultate të institucionit, duke modifikuar proceset, strukturat dhe gjithë zinxhirin ekonomik të vlerës, në përputhje me standardet përkatëse (pra eficiencën); si dhe arritjen e objektivave të vendosura në përputhje me politikat e subjektit nën auditim (pra efektivitetin).

Gjatë kryerjes së këtij auditimi, jemi përpjekur t'i japim përgjigje pyetjes: **“A është respektuar e drejta e autorit në fushën e muzikës dhe kinematografisë, referuar objektivave të vendosura nga Strategjia Kombëtare e Pronësisë Industriale dhe Intelektuale 2010-2015?”** dhe në përfundim Mesazhi i Auditimit është :

“Pavarësisht një plani të mirëdetajuar, pjesë integrale e Strategjisë Kombëtare për Pronësinë Industriale dhe Intelektuale 2010- 2015, që synonte përmirësimin e ndjeshëm të respektimit të së drejtës së autorit, vonesa në miratimin e një ligji të cilin do të reflektoheshin praktikatat më të mira botërore dhe evropiane, si dhe mungesa e koordinimit të veprimeve të institucioneve të ngarkuara me monitorimin e respektimit të kësaj të drejte, ka sjellë si pasojë respektimin në nivel të ulët të drejtave të autorëve/interpretuesve në fushën e muzikës dhe kinematografisë”.

Nisur nga konkluzionet mësipërme dhe rezultatet e punës audituese, duke synuar përmirësimin e mëtejshëm të këtij sektori Kryetari i KLSH-së:

V E N D O S I:

I. Të miratojë Raportin Përfundimtar të Auditimit të Performancës **“Respektimi i të Drejtës së Autorit në Shqipëri”**, të ushtruar në Zyrën Shqiptare për të drejtën e Autorit, Autoritetin e mediave Audiovizive dhe Ministrinë e Kulturës.

II. Të miratojë rekomandimet e përcaktuara dhe të kërkoj marrjen e masave për sa vijon:

1. Ministria e Kulturës të analizojë dhe të nxjerrë përgjegjësitë për propozimin dhe vendimmarrjen e nxituar për licencimin dhe rilicencimin e 4 agjencive të administrimit kolektiv(AAK), vendimmarrje kjo e cila është bërë pa shqyrtuar hollësisht aktivitetin e mëparshëm të agjencive të administrimit kolektiv dhe pa kryerjen e një hetimi të mirëfilltë administrativ nga ana e ZSHDA, siç parashikohet në VKM nr. 232, dt. 19.04.2006 **“ Për krijimin dhe funksionimin e Zyrës Shqiptare për të Drejtën e Autorit”**.

Menjëherë

2. Referuar Ligjit nr. 9380, dt. 28.04.2005 **“Për të Drejtën e Autorit dhe të Drejta të tjera të lidhura me të”**, të ndryshuar dhe të VKM nr. 232, dt. 19.04.2006 **“Për krijimin dhe funksionimin e ZSHDA”**, Zyra Shqiptare për të Drejtën e Autorit të miratojë një rregullore/udhëzim për monitorimin dhe kontrollimin e veprimtarisë së AAK. Hartimi i një rregulloreje/udhëzimi të tillë e bën më efektive punën e ZSHDA për monitorimin e AAK dhe identifikon në një fazë më të hershme problemet që këto AAK mund të kenë gjatë ushtrimit të licencës.

Menjëherë

3. Zyra Shqiptare për të Drejtën e Autorit të kërkojë nga Agjencitë e Administrimit Kolektiv depozitimin pranë saj të kontratave të autorëve me AAK për plotësimin e detyrimit për regjistrimin dhe certifikimin e kontratave me autorët.

Menjëherë

4. ZSHDA në intervale të rregullta kohore të kërkojë nga AMA informacion të përditësuar për kontratat e OSHMA-ve të depozituara në këtë institucion, në mënyrë që këto subjekte transmetuese të njoftohen prej saj për plotësimin e detyrimit për regjistrimin e çdo kontrate për kalim të drejtash ekskluzive/joekskluzive.

Menjëherë

5. ZSHDA të marrë masa për miratimin e Rregullores së Inspektimit të subjekteve përdoruese, dokument në të cilin të rregullohet çdo proces i procedurës së inspektimit.

Brenda tremujorit të parë të vitit 2016

6. ZSHDA bazuar në inspektimet e kryera dhe problematikave të evidentuara ndër vite, të kryej analizën e riskut dhe të hartojë një database për subjektet që paraqesin risk më të lartë për cënimin e të drejtës së autorit. ZSHDA të hartojë dhe të miratojë çdo fillim viti planin e inspektimit, i cili duhet të bazohet në analizën dhe database-in e subjekteve me risk më të lartë.

Brenda tremujorit të parë të vitit 2016

7. Për ngritjen e kapaciteteve inspektuese dhe të efektivitetit të sektorit të inspektimit, ZSHDA të intensifikojë bashkëpunimin me Inspektoriatin e Qendror për trajnimin e personelit inspektues.

Vazhdimisht

8. ZSHDA dhe Ministria e Kulturës të analizojnë dhe miratojnë fondet e nevojshme për një mbulim sa më efektiv gjeografik të inspektimit të subjekteve përdoruese të së drejtës së autorit në Shqipëri.

Vazhdimisht

9. Zyra Shqiptare për të Drejtën e Autorit dhe Autoriteti i Mediave Audiovizive të intensifikojnë përpjekjet për krijimin e një bashkëpunimi sa më efikas nëpërmjet nënshkrimit të një Memorandumi Bashkëpunimi, në të cilin theksi kryesor të jetë shkëmbimi i gjerë dhe i detajuar i informacionit për aktivitetin e subjekteve përdoruese transmetuese, hartimi i strategjive të përbashkëta për monitorimin dhe respektimin e të drejtës së autorit dhe të drejtës së transmetimit, si dhe hartimi i planeve të përbashkëta të inspektimit.

Brenda 6 mujorit të parë të vitit 2016

10. ZSHDA të analizojë dhe të nxjerrë përgjegjësitë për numrin e ulët të arkëtimit të masave administrative të vendosura.

Gjatë 3 mujorit të parë të vitit 2016

11. ZSHDA për përmbushjen me efikasitet të detyrave të saj kryesore që janë inspektimi e monitorimi i të drejtës dhe shqyrtimi i ankesave nga autorë apo titullarë të së drejtës të

kërkojë nga Ministria e Kulturës fonde për ngritjen e Zyrave Rajonale të Drejtës së Autorit dhe shtimin e strukturës së Sektorit të Ankimimit.

Brenda vitit 2016

12. Për përmbushjen e detyrave funksionale të ZSHDA-së, Ministria e Kulturës, të planifikojë në buxhetin e kësaj zyre, fonde për trajnime apo projekte dhe shërbime që rrisin performancën institucionale për garantimin e të drejtës së autorit.

Vazhdimisht

13. ZSHDA në bashkëpunim me institucionet e ndryshme që ligji i ngarkon me respektimin e të drejtës së autorit, të hartojë një plan të mirëdetajuar për organizimin e fushatave sensibilizuese, me qëllim informimin dhe ndërgjegjshmin e publikut të gjerë dhe përdoruesve të së drejtës së autorit.

Vazhdimisht

14. ZSHDA të intensifikojë përpjekjet e saj duke shfrytëzuar të gjithë instrumentet që i mundëson ligji për sistemin arsimor parauniversitar në Republikën e Shqipërisë dhe ligji për arsimin e lartë për trajtimin e respektimit të së drejtës së autorit në curriculat parauniversitare dhe universitare.

Vazhdimisht

15. ZSHDA nëpërmjet një analize të thelluar të shkaqeve dhe problematikave të cilat kanë sjellë lëvizjen e stafit dhe për rrjedhojë ulin efektivitetin e punës së kësaj , të hartojë një strategji të qartë për rekrutimin dhe trajnimin e punonjësve të saj.

Brenda 6 mujorit të parë të vitit 2016

16. Për të rritur efektivitetin e veprimtarisë të studios së monitorimit, Autoriteti i Mediave Audiovizive të marrë masa për analizimin e nevojave që ka kjo studio për monitorimin e subjekteve të licencuara prej saj dhe të marrë masa për financimin e modernizimit të kësaj studioje, pasi vetëm modernizimi i saj garanton monitorimin bashkëkohor dhe respektimin e të drejtës së transmetimit e të së drejtës së autorit.

Vazhdimisht

17. Në përmbushje të detyrimeve të Ligjit Ligji 97/2013 “Për Mediat Audiovizive në Republikën e Shqipërisë”, Autoriteti i Mediave Audiovizive të marrë masa që në inspektimet e tij përveç monitorimit të së drejtës së transmetimit të inspektojë subjektet në mënyrë të barabartë edhe për respektimin e të drejtës së autorit.

Vazhdimisht

18. Duke qenë se burimet financiare të AMA-s lejojnë monitorimin dhe inspektimin e plotë të të gjithë OSHMA-ve, AMA të marrë masa për shfrytëzimin e këtyre burimeve financiare për inspektimin e OSHMA-ve me synim respektim sa më efektiv të së drejtës së transmetimit dhe të së drejtës së autorit.

Vazhdimisht

19. Për përmbushjen e detyrimeve që rrjedhin nga Ligji 97/2013” Për Mediat Audiovizive në RSH” për garantimin e respektimit të së drejtës së autorit, AMA pas analizës së nevojave për trajnim të punonjësve të saj për fusha konkrete të së drejtës së autorit, në bashkëpunim me ZSHDA dhe institucione të huaja të marrë masa për kryerjen e

aktiviteteve trajnuese. Vetëm shtimi i njohurive të stafit dhe trajnimi efektiv i punonjësve të AMA kontribuon në respektimin efektiv të drejtës së autorit në fushën e muzikës dhe kinematografisë.

Vazhdimisht

20. Ministria e Kulturës në përmbushje të detyrimeve ligjore si institucion epror i ZSHDA, nëpërmjet strukturave të saj si Drejtoria e Auditimit të Brendshëm të auditojë dhe të kontrollojë në mënyrë periodike aktivitetin e ZSHDA.

Vazhdimisht

21. Në zbatim të neni 28, pika 5b të Rregullores së Ministrisë së Kulturës, përveç mbikëqyrjes së veprimtarisë së ZSHDA për realizimin e objektivave politike dhe të menaxhimit, ligjshmërisë e përputhshmërisë së veprimeve të saj administrative, në mënyrë të veçantë të fokusohet tek inspektimi i veprimtarisë së ZSHDA për monitorimin e aktivitetit të AAK, të cilat licencohen për të përfaqësuar denjësisht të drejtat e autorëve në treg dhe për të shpërndarë në mënyrë transparente dhe të drejtë këto të ardhura tek autorët.

Vazhdimisht

Grupi i auditimit

Alma SHEHU

Jorida ZHEGU


Drejtore
Rinald MUÇA

Tiranë, Dhjetor 2015